

# VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.  
TË LUTEM KOPJOJE!

GAZETË JAVORE | 12 shtator 2005 | nr. 5 | www.vetevendosje.org

## Deklarata qytetare

10 qershor 2004

Askush nuk mund të kalërojë mbi kurrizin tënd  
po qe se nuk i përkulesh.  
Martin Luther King Jr.

Duke u nisur nga fakti se Kosova sot qeveriset nga një strukturë ndërkombëtare, që nuk gëzon legjitimitet e as mandat nga populli i Kosovës;

Duke u nisur nga fakti se institucionet e Kosovës nuk përfaqësojnë drejtë vullnetin e popullit, si në pikëpamje politike, ashtu dhe ekonomike e sociale;

Duke u nisur nga fakti se partitë politike nuk janë dëshmuar si përçuese të denja të interesave qytetare, por shërbejnë si struktura të mbyllura që kanë shndërruar politikën kosovare në një oligarki;

Duke u nisur nga fakti se Korniza Kushtetuese është dokument i papranuar nga populli në plebishit, pra që nuk gëzon legjitimitetin e popullit të Kosovës;

Duke u nisur nga fakti se statusi i Kosovës rrezikon të zgjidhet në kundërshtim me vullnetin e popullit, gjë që paraqet burim tensionesh dhe konfliktesh të reja;

Duke u nisur nga fakti se zhvillimet e pesë viteve të fundit e kanë izoluar Kosovën ndërkombëtarisht, përkundër dëshirës dhe vullnetit të popullit për t'iu bashkuar procesit integruar në Evropë dhe për t'u partnerizuar me strukturat evro-atlantike;

Duke u nisur nga fakti se gjendja ekonomike në Kosovë ka fituar përmasa katastrofike dhe kërkon masa radikale dhe të menjëhershme për tejkalimin e saj;

Duke u nisur nga fakti se pjesa më e madhe e popullatës në Kosovë, ajo nën moshën 25 vjeçare, nuk gëzon kushtet e arsimit adekuat, dhe nuk ka perspektivë ekonomike dhe të pavarësisht individual;

Duke u nisur nga fakti se secili qytetar i Kosovës, padrejtësisht konsiderohet dhe trajtohet vetëm si banor, status ky që e fiton



edhe refugjati, dhe se kjo pamundëson ndërtimin e një shoqërie të hapur, demokratike me liri e barazi për të gjithë;

Ne, si qytetarë të Kosovës dhe aktivistë, nxjerrim këtë Deklaratë:

Shpallim se JEMI QYTETARË të Kosovës, se na takojnë dhe duhet t'i gëzojmë të gjitha të drejtat njerëzore dhe qytetare të parapara sipas konventave ndërkombëtare dhe evropiane.

Këto të drejta, përveç tjerash, nënkuptojnë se qytetarit të Kosovës, në asnjë rast, nuk mund t'i mohohet:

- e drejta për jetë;
- e drejta e mendimit dhe shprehjes së lirë;
- e drejta e qarkullimit dhe lëvizjes së lirë, brenda dhe jashtë territorit të Kosovës;
- e drejta e posedimit dhe mbrojtjes së pronës;
- e drejta për të informuar dhe për t'u informuar nga burime që zgjedhen vetë;
- e drejta për t'u bashkuar dhe vepruar në bashkim me të tjerët;
- e drejta për t'u njohur para ligjit dhe drejtësisë si qytetar pa dallim race, etnie, feje, gjinie, orientimi seksual apo karakteristike tjetër, pos në rastet kur kjo ka-

rakteristikë përdoret nga organet apo nga ndonjë palë tjetër për diskriminimin, nënçmimin, ofendimin apo shkëlqen e të drejtave të qytetarit në bazë të karakteristikës së përmendur;

- e drejta për mbrojtje në rast arresti;
- e drejta për t'u gjykuar drejtë nga një gjykatë me mandat legjitim, në bazë të ligjeve të vendosura nga organi përfaqësues ligjvënës i Kosovës;
- e drejta për të zgjedhur, përmes votës së lirë, përfaqësuesit në organet në të gjitha nivelet e pushtetit;
- e drejta e pamohueshme për bashkim në parti, asociacione dhe shoqëri të tjera politike, me apo pa synuar votën e popullit;
- e drejta për arsimim;
- e drejta për mbrojtje shëndetësore, pa pagesë apo me pagesë të përballueshme;
- e drejta për mbrojtje sociale;
- e drejta për nxjerrjen e dokumenteve personale dhe të udhëtimit;
- e drejta për ruajtjen e lidhjes me vendlindjen në rast emigrimi.

Si qytetarë të Kosovës dhe aktivistë, zotohemi se me përkushtim dhe vendosmëri, përmes akcioneve të padhunshme dhe publike do të synojmë fitimin dhe realizimin e të drejtave tona.

### Editorial

Edhe ndaj objekteve e kafshëve njeriu ka njëfarë obligimi e detyrimi, por jo edhe UNMIK-u ndaj nesh. Në vendet demokratike pushteti ka obligime, qytetarët kanë të drejta; te ne, UNMIK-u s'ka detyrime ndaj nesh, ne s'kemi të drejta. Madje vlen e kundërta: PSSP-ja ka të drejta të rezervuara, ndërkaj në kemi obligime në bazë të standardeve që duhet t'i përmbushim. Thuajse i kemi borxh atij! Kjo është në konsistencë me faktin se ne nuk e kemi zgjedhur UNMIK-un, se ne s'votojmë për pushtetin absolut që ai mbanë, dhe se as brenda tij s'votohet për vendimet që merren.

Përveçqë është regjim antidemokratik, UNMIK-u është edhe regjim antiqytetar. Vendasit në Kosovë konsiderohen vetëm si banorë. Pra, ne jemi banorë këtu, që do të thotë se mund të banojmë edhe gjetiu dhe se Kosova disi nuk është shtëpia jonë. Jemi qiraxhinj në të. Përveçse nuk kemi pushtet në shtëpi, nuk kemi as të drejtë mbi të. Një padrejtësi e këtu është e kodifikuar. Rregullat dhe ligjet janë përshtatur sistemit, jo njerëzve. Në Kornizën Kushtetuese shkruan se jemi banorë, jo qytetarë. Në dokumentet e udhëtimit dhe kudo që jemi regjistruar, jemi vetëm banorë. PSSP-ja nuk i nënshkruan ligjet e Kuvendit pa u zëvendësuar secila fjalë qytetar me fjalën banor. Ky banor i Kosovës ndodhet në mes të pafuqisë dhe paafësisë së institucioneve vendëse, dhe gjithëfuqisë e diktaturës së UNMIK-ut.

Me 10 qershor 2004, atëherë kur u bënë pesë vjet të Rezolutës 1244, në qendër të Prishtinës, rreth e përqark hapësirës së rrethuar me grila e tela ku gjendet UNMIK-u, u pat mbajtur një protestë. Kjo protestë kulmoi në orën 12:44, me kartuqa të kuq dhe vërshëllima të pipave, me leximin e Deklaratës Qytetare dhe me shpalljen e vetes sonë QYTETARË. E organizuar nga Rrjeti i Aksionit për Kosovën (KAN), në këtë protestë ishin të pranishëm pjesëmarrës nga e gjithë shoqëria: punëtorë dhe të papunë, nxënës, studentë dhe arsimtarë, të rinj e të moshuar, dhe disa shoqata e organizata të ndryshme. Protestohet kundër degradimit që na bëhej, kundër trajtimit si banorë. Kërkohej njohja e statusit të qytetarit, për secilin në Kosovë, pa kurrfarë diskriminimi, si burim i sovranitetit, dhe i cili gëzon të gjitha të drejtat njerëzore e qytetare të parapara sipas konventave ndërkombëtare e evropiane. Kërkohej edhe caktimi i datës sa më të shpejtë të përfundimit të misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë - UNMIK-ut. Ajo që u fillua me 10 qershor 2004, dhe që u vazhdua me shumë aksione në muajt në vijim, do të sublimohet me 12 qershor 2005 me shkrimin e parullës JO NEGOCIATA - VETËVENDOSJE!, e që shënon avansimin e KAN-it në Lëvizjen VETËVENDOSJE! Ne konsiderohemi banorë pikërisht sepse nuk konsiderohemi qytetarë, e kjo ngjanë ngase popullit të Kosovës i mohohet vetëvendosja, sepse Kosovës i mohohet sovraniteti.

UNMIK-u jo vetëm që nuk na pranon e njuh si qytetarë, por as si njerëz. UNMIK-u është edhe regjim antinjerëzor. Në vend të vlerave universale, në Kosovë kemi standarde partikulare të imponuara. Para më shumë se gjashtë vjetëve është bërë kompromis për të ardhur UNMIK-u. Tash po përgatitet një tjetër kompromis për të shkuar ai. Në çdo aspekt ne vazhdojmë të jemi të shtypur kolektivisht. Prandaj, vetëm kolektivisht mund të lirohemi nga kjo shtypje.

Albin Kurti





# Qytetaria

**Gëzim Krasniqi**

Një nga tiparet e rëndësishme dalluese e përcaktuese në mes individëve në shoqërinë bashkëkohore, pa dyshim, është edhe qytetaria. Një përcaktim i tillë, pra termi qytetari, daton qysh nga koha e qyteteve-shtete në Greqinë e lashtë, dhe përdoret për të përmbledh të drejtat dhe detyrimet e individit që lidhen me përkatësinë në një njësi shoqërore. Si tipar i përkatësisë së individit në një shoqëri, qytetaria sot paraqet statusin juridik të individit në shoqëri, me të cilin lidhen një shumësi të drejtash dhe obligimesh. Në rastin konkret, një njeri që jeton në shtetin e caktuar, ai është i definuar si qytetar i atij shteti, me ç'rast fiton të drejtat dhe detyrimet e përcaktuar me ligjin e po atij vendi; ky është aspekti legal i qytetarisë. Në aspektin tjetër, atë njerëzor, qytetaria është participimi aktiv i njerëzve, aksioni politik i tyre. Pra, përderisa në rastin e parë qytetaria dhe qytetari përcaktohen me ekzistimin e një baze ligjore, në rastin tjetër, qytetaria dhe qytetari ekzistojnë të bazuara në veprimin e individit.

Në aspektin legal, në Koso-

vë nuk ka qytetari dhe qytetarë. Në Kosovë ka banorë. Këtë e sanksionon Rezoluta 1244, sipas së cilës rezolutë, të gjithë njerëzit që jetojnë në këtë vend janë të përkufizuar si banorë. Një përkufizim i tillë i njerëzve që jetojnë në Kosovë, është përçmues deri në ekstrem, për arsyen e thjeshtë se kjo nuk është vetëm çështje e terminologjisë, por është çështje shumë përmbajtësore. Është përçmues, ngaqë çdo njeri në botë, qoftë ai refugjat, i deportuar, pa shtet a pa komb, është i definuar dhe trajtuar si banor. Në anën tjetër, nocioni qytetar nënkupton shumë më shumë; qytetari ka shumë më shumë liri dhe të drejta sesa banori, por njëkohësisht, ka edhe përgjegjësi. E, në rastin e Kosovës - njerëzit që jetojnë këtu, në bazë të Rezolutës 1244, janë të detyruar të kryejnë të gjitha obligimet qytetare (respektim i rendit, ligjit, obligimet tatimore etj), pa pasur të drejtë të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tjera që i kanë të gjithë qytetarët në shoqëri dhe vende të tjera të botës. Si rrjedhim, njerëzit që jetojnë në Kosovë s'kanë të drejtë të quhen qytetarë të Kosovës - ata quhen banorë të Kosovës; ata s'kanë të

drejtë të kenë pasaportë - kanë vetëm dokument udhëtimi; ata s'kanë të drejtë të ankohen për padrejtësi në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë - janë të detyruar që në bazë të Rezolutës 1244 t'iu binden vendimeve arbitrare të administratës ndërkombëtare; ata mund të mbahen në masën paraburgim për kohë të pacaktuar - sistemi aktual nuk iu siguron kurrfarë mekanizmi për mbrojtje të të drejtave të tyre, etj. etj.

Si rezultat i një përcaktimi të tillë skajshmërisht përlulës dhe jonjerëzor, sistemi aktual politik në Kosovë ka krijuar njerëz jashtë politike, të zhveshur nga çfarëdo subjektiviteti politik, e që po u dashka të udhëhiqen nga 'tutorët' ndërkombëtarë. Regjimi neokolonialist i UNMIK-ut dhe sistemi politik në Kosovë në përgjithësi, kultivon mashtrimin frikësues, oportunizmin, apatinë, që janë të pranishme kudo. Pra, produkt i këtij sistemi është njeriu i robëruar dhe i shantazhuar. Mbase dikush do të mund të pohonte se në Kosovë ka liri politike dhe qytetari, për faktin që këtu njerëzit mund të ushtrorjnë të drejtën e votës. Mirëpo, liria politike dhe qytetaria nuk konsistojnë vetëm në drejtën

universale të votës; e drejta e votës nuk është maksimumi i lirisë politike dhe qytetarisë. Përkundrazi, nëse e drejta e votës, përmes së cilës njerëzit mund të zgjedhin përfaqësuesit e tyre politikë, është vetëm kushti më themelor i lirisë politike dhe qytetarisë së individit në një shoqëri. E drejta e votës konsiderohet ushtrim i demokracisë dhe liri politike, vetëm nëse ajo shoqërohet me mundësinë e zgjedhësve për të kontrolluar pushtetin politik në vazhdimësi. Kosova realisht udhëhiqet nga administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut, e cila është e paqarshme dhe e paarritshme institucionalisht për njerëzit që jetojnë në Kosovë - ata që votojnë dhe ata që s'votojnë. Në një gjendje të tillë, zgjedhjet në Kosovë janë mashtrim i vërtetë dhe krijim i iluzionit se këtu ka liri politike dhe qytetari.

Sot, e kundërta e mohimit legal të qytetarisë në Kosovë është Lëvizja VETËVENDOSJE! Me aktivitetet e saj të ditë-përditshme dhe me përfshirjen në to të mijëra të rinjëve dhe të rejave të këtij vendi, Lëvizja VETËVENDOSJE! është lëvizje e mirëfilltë qytetare. Në kushtet e mungesës së qytetarisë në Kosovë në aspektin

legal, aksionet e kësaj lëvizjeje janë jetësimi i qytetarisë në aspektin njerëzor. Pjesëmarrja aktive dhe aksioni i vazhdueshëm politik e qytetar i aktivistëve të lëvizjes, sot përbëjnë qytetarinë në Kosovë. Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk është një bashkim rasti - delegjitimimi dhe delegalizimi i plotë i sistemit neokolonialist të UNMIK-ut në vendin tonë, të pasuara me arritjen dhe realizimin e drejtës për vetëvendosje të jashtme dhe të brendshme të popullit të Kosovës, janë esenca dhe kushti i domosdoshëm i aktivizimit dhe ekzistencës së saj.

Qytetaria është një funksion shoqëror konkret, ajo siguron tagra, të cilat përbëjnë të drejtat. Kësisoj, aksioni politik dhe participimi aktiv i tanishëm në Kosovë, të mishëruara në aktivizmin dhe veprimtarinë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, e bëjnë këtë të ketë një funksion shoqëror konkret në vendin dhe shoqërinë tonë. Si e tillë, Lëvizja VETËVENDOSJE! synon sigurimin e tagrave për popullin e Kosovës. Tagra që ajo synon, përbën të drejtën që na mohan sistemi aktual politik - vetëvendosjen. Sepse ajo i kthen kuptimin ndjenjës njerëzore për liri, dinjitet dhe vetëpërcaktim të së ardhmes.



# Tërësia/Pjesa. Cila?

**Glauk Konjufca**

Para jo më shumë se një viti, një fantazmë ende mbi botën perëndimore - skandali i qindra priftërinjëve pedofilë. Ata që hiqeshin si 'ajka morale' e një shoqërie, ata të cilët pretendonin të kenë mbrojtur vlerat më sublimë në kohën kur bota perëndimore është zhytur si kurrë më parë në një 'hedonizëm të papërmbajtur', pikërisht ata, për një orë seç u shndërruan në njerëzit më të urryer. Por, jo të gjithë u shokuan, jo gjithkush u trondit nga kjo ndodhi neveritëse. Slavoj Zhizheku mendon që kjo ngjarje ishte prodhim i domosdoshëm i mënyrës se si strukturimi i Kishës si institucion (keq)menaxhon me ekonominë libidinale të pjesëtarëve të saj. Dhe, mirë e ka. Matrix-i rregullativ sistemik i sjelljes përbrenda Kishës krijon ca 'vrime', në të cilat gjen shkarkesë të pashmangshme patologjia e prirjeve seksuale. Ky problem nuk zhduket po u ndoqën penalisht aktkryesit, ai nuk merr fund as nëse ata burgosen. Sepse problemi nuk qëndron te ky apo ai prift i caktuar - ai është sistemik për nga natyra. Çdo përpjekje që për zgjidhjen e problemeve sistemike ka për pikënisje vetëm problematizimin e pjesëve të sistemit, e jo vetë koordinatat e tij, jorastësisht është e gjykuar të dështojë.

Kosova është problem sistemik. Sistemi përbëhet nga pjesë të shumta: UNMIK-u, IPVQ-të, KFOR-i... Por, prit! Një përshkrim i tillë duket të jetë i pasaktë. UNMIK-u s'është vetëm një pjesë e thjeshtë mes shumë tjerash. Ai është dizajneri autoritar i raportit të të gjitha pjesëve, arbitër absolut i marrëdhënieve mes tyre. Është UNMIK-u ai që përcakton raportin nënshtrues ndaj IPVQ-ve. Pra, ai është vetë sistemi.

Struktura e rregullave të UNMIK-ut prodhon naty-

rën e IPVQ-ve. Aty janë të mbrojtur kufijtë ontologjikë të institucioneve tona politike. Në momentin që ndonjëri nga këto institucione, qoftë edhe për një grimë, shkel rregullat që s'i ka vetë vetë, atij i tërhiqet vërtetja nga UNMIK-u (PSSP-ja), sanksionohet, ose pushon së ekzistuari. Kjo është arsyeja pse Peterseni para ca muajve shfuqizoi 28 ligje të aprovuara nga i ashtuquajti Parlament i Kosovës. Vetëm e vetëm ngaqë në këto ligje ishte përdorur termi 'qytetar'. Sipas dokumenteve bazike mbi të cilin legalisht legjitimohet puna e këtij sistemi piramidial jodemokratik, koncepti fundamental politik 'qytetar' ndalohet të përdoret. Tashmë dihet: nga ky sistem neokolonialist ne po trajtohem si refugjatë në shtëpinë tonë, të privuar nga çfarëdo subjektiviteti politik real.

Strukturimi i pushtetit brenda vendit tonë krijon një rreth vicioz, i cili për nga natyra hermetike len qytetarin absolutisht jashtë, pa qenë në gjendje të vëjë çfarëdo urash për realizimin e interesave të tij. Dhe, s'mund të ndodh ndryshe. Në majë të strukturës piramidale qëndron UNMIK-u, juridikisht i paprekshëm, e pra, absolutisht i stërkequr. Pjesë e nënshtruar integrale e tij janë IPVQ-të. Këto të fundit shërbejnë për dy arsye themelore. Së pari, ato krijojnë iluzionin e demokracisë në shoqërinë tonë. Kjo është pjesë e strategjisë së menaxhimit të pakënaqësive të popullit. Së dyti, UNMIK-u nuk ka leverdi ekonomike ta mbajë vetveten. Ai nuk ka llogari të paguajë 120 ekspertë juridikë ndërkombëtarë nga 10.000 euro në muaj për secilin, të cilët do të nxirrnin ligje për UNMIK-un, në një kohë kur këtë punë e kryejnë për mrekulli deputetët e Parlamentit për vetëm 600 euro! Buxheti i Kosovës shërben për ndërtimin e bazamentit juridik të UNMIK-ut, e jo

për avansimin e interesave të qytetarëve. Çka tjetër mund të prodhojë ky sistem, përpos varfërimit e shumicës së popullit dhe korrupsionin masiv të pushetarëve? Asgjë.

Problemet sistemike kërkohen zgjidhje sistemike. Të përpiqesh që problemin e vendit tonë ta shohësh si problem të një ministri të korrumpuar apo të një zyrtari të paditur, do të thotë ta kesh huqur totalisht perspektivën e zgjidhjes së tij. Është punë sistemi, e jo individësh të caktuar. Kapemi nxitimthi pas skandalit të një ministri, i cili shpërdoron tendere, gjejmë veprime të mira te një kryeadministrator, ndërkaq te një tjetër ndërmarrje dashakeqe, shohim zgjidhjen e problemit të Universitetit vetëm pse u ndërrua Rektori... Kjo logjikë është pikërisht ajo që e fsheh natyrën e vërtetë të problemit. Nuk duhet problematizuar vetëm korrupsionin e ministrit, por - mbi të gjitha - kushtet që tolerojnë dhe mundësojnë shpërdorime të tilla; dallimet e veprimeve të kryeadministratorëve s'janë vendime të tyre personale, por materializim i planit të tyre të punës, përmbytja e të cilit përcaktohet nga tjetërkush (Këshilli i Sigurimit i OKB-së, p.sh). Njëjtë, problemi i Universitetit nuk zgjidhet po u ndërrua një udhëheqës i politizuar, por kur politizimi si fenomen sanksionohet strukturalisht aty. Por, gjithsesi, kjo nuk bën që aty të zgjidhet edhe çështja e mungesës pothuajse totale të cilësisë së studimeve.

Për sa kohë që sistemi të jetë ky që është, nëpër vrime e krijuara nga ai, gjithnjë do të rrjedhin ujëra të zeza. E, të tilla ujëra do të kemi gjithnjë, përdërisa të mos ndryshojmë vetë sistemin, e jo vetëm pjesët e tij, të cilat riprodhojnë vetveten pandalë. Sepse sistemi është më shumë se pjesët e tij.



## KOMENT **Votimi i kompromisit, dorëheqja e Kosumit dhe Manastiri i Deçanit**

**Shkëlzen Gashi**

**1.** Bajram Kosumi ka deklaruar se Kuvendi i Kosovës e ka përgjegjësinë për harmonizimin e të gjitha qëndrimeve, dhe çdo projekt apo nismë për statusin duhet ta ketë vullnetin e deputetëve. Po të ishin projektet apo nismat eventuale për statusin e Kosovës në përputhje me vullnetin e popullit, atëherë, pse do të duhej që projektet e këtilla të votoheshin nga deputetët e Kuvendit të Kosovës?! Deputetët e këtij Kuvendi do të votojnë për projektet që do t'iu servohen, dhe këtë e dëshmon më së miri fakti se ata votojnë po qe se një gjë e tillë kërkohet nga liderët e tyre partiakë, pa marrë parasysh se a janë projektet e tilla në kundërshtim me aspiratat e popullit. E njëjta gjë pat ndodhur edhe me deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës - të dalur nga zgjedhjet e 22 marsit të vitit 1998 - të cilët në mars të vitit 1999 patën votuar Marrëveshjen e Rambujesë, sepse kështu pat kërkuar lideri i tyre - dr. Ibrahim Rugova. Vetëm një votë ka qenë kundër. Ka shumë gjasa që të përsëritet historia.

**2.** Problemi në Kosovë nuk është problem individësh, por sistemik. Më kot angazhohemi që ta detyrojmë një ministër të korrumpuar, apo, po qe se doni edhe kryeministrin, të japë dorëheqje. Çfarë do të ndodhë, ta zëmë, po qe se Bajram Kosumi jep dorëheqje?! Asgjë! Zëvendësohet me dikë tjetër dhe prapë ne do të ballafaqohemi me problemin e njëjta. Do të ballafaqohemi me bazën e këtij sistemi të padrejtë politik. Dorëheqja e Kryeministrit të Kosovës është aq e rëndësishme sa edhe dorëheqja e ndonjë shefi

në ndonjë departament të ndonjë ministrie të ndonjë shteti. Mu për këtë, angazhimi i disa partive dhe OJQ-ve për dorëheqjen e kryeministrit, edhe po qe se ndodhë, s'mund të ketë tjetër rezultat përveç atij të ndryshimit të personit në krye të Qeverisë. Në këtë mënyrë, koncentrimi i energjisë në përpjekjet për të zëvendësuar persona të ndryshëm në institucione, realisht është shpërqendrim nga thelbi i problemit - sundimi neokolonialist i UNMIK-ut dhe mungesa e lirisë në Kosovë. Fundja, në realitet Bajram Kosumi nuk është kryeministër. PSSP është kryeministër!

**3.** Siç dihet, përveç decentralizimit, për fat të keq, paralelisht është duke ngjarë edhe një proces tjetër tepër i dëmshëm dhe që i kontribuon ndarjes së Kosovës: njohja e statusit eksterritorial për disa kisha dhe manastire. PSSP-ja, Soren Jessen-Petersen, ka përcaktuar si zonë speciale Manastirin e Deçanit, dhe për këtë s'e ka pyetur as Komunën e Deçanit dhe as Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. E pse t'i pyes?! Për ndryshimin e kufijve të komunave, PSSP-ja ka kompetenca të pakufizuara. Peterseni është këtu që ta zbatojë Rezolutën 1244. Pra, problemi, në rradhë të parë, është te Rezoluta 1244. Me vendimin special të PSSP-së, 800 hektarë tokë përreth Manastirit të Deçanit janë shpallur zonë speciale, e prej këtyre 800 hektarëve, rreth 80% janë toka private të banorëve të Deçanit, të cilët kanë problem për ta punuar tokën e tyre, sepse procedurat për të shkuar në tokën e tyre janë të ngajshme me ato të kalimit të kufirit shtetëror.



**LETËR BANORËVE TË FSHATIT CERNICË - KOMUNA E GJILANIT**

# "Decentralizimi" - një emër tjetër për copëtimin e Kosovës

Sikur të mos mjaftohej me padrejtësinë kriminale që na është bërë në vazhdimësi, Qeveria e Serbisë, kohë më parë, ka dalë me planin e saj për ndarjen e Kosovës. Ky projekt, duke pasur për qëllim çimentimin e ndarjeve të dhunshme që i janë bërë vendit tonë, synon që copëtimin e tij ta bëjë jo vetëm realitet faktik, por edhe një arritje të njohur ndërkombëtarisht. Dhe, një gjë e tillë është paraparë të realizohet përmes procesit të decentralizimit, proces ky që, fatkeqësisht, po udhëhiqet nga institucionet politike të Kosovës, me saktësisht nga Qeveria e Kosovës. Ky projekt është në kundërshtim absolut me interesat tona. Para se ta rimarrë Kosovën, Serbia do që ta copëtojë atë. Serbët aktualisht përbëjnë vetëm 5% të popullatës në Kosovë. Edhe me kthimin e serbëve nga Serbia ata realisht nuk do të mundin të jenë më shumë sesa 8%. Ndërkohë, me enklavat e tyre që do të zgjerohen në Kosovën e decentralizuar, serbët do të mundin të kenë afër 25% të territorit të Kosovës. Serbia tanimë ka kontroll të plotë në pjesën më të madhe të veriut të Kosovës, dhe kjo është arsyeja se pse plani i decentralizimit nuk është paraparë të aplikohet në atë pjesë, por në pjesët tjera të Kosovës ku ka serbë dhe ku Serbia nuk ka kontroll të plotë. Rajoni i Anamoravës veçanërisht është i rrezikuar shumë nga ky proces. Qeveria e Kosovës tashmë veç ka vendosur që në vend të Zhegrës (për të cilin fshat partitë politike gjatë fushatës zgjedhore patën premtuar se do të bëhet komunë) do të jetë Parteshi ai që do të bëhet komunë e re. Dhe, në mënyrë që tek qytetarët të krijohet bindja se decentralizimi nuk po bëhet për serbët, Qeveria e Kosovës ka paraparë që përveç Budrigës së Poshtme që është e banuar me serbë, Parteshit t'i bashkohet edhe Cernica që është e banuar edhe me popullatë shqiptare. Gjithsesi, në komunën e re shqiptarët do të jenë pakicë, d.m.th do të jenë të dominuar nga serbët lokalë. Pra, popullata shqiptare e fshatit Cernicë sipas Planit B të decentrali-



zimit do të inkuadrohet brenda një komune serbe, në të cilën komunë do të vazhdojnë të ekzistojnë strukturat paralele serbe dhe formacionet e armatosura të financuara nga shteti i Serbisë. Pra, do të ketë një legalizim të pranisë së shtetit të Serbisë në Kosovë. Për më keq, komuna e Parteshit pastaj lidhet me fshatin Pasjan që ka 2.160 banorë serbë për të siguruar kështu lidhje fizike me kufirin e Serbisë përmes fshatit Muçibabë ku jetojnë jo më shumë se katër familje shqiptare. Serbët aktualisht e refuzojnë Planin B, jo se ai nuk u levërdis, por për shkak se atë e kanë kurdo, dhe ata duan edhe më shumë se kaq (Planin C...).

I gjithë procesi i decentralizimit po shkon sipas planeve serbe për të krijuar një "zonë sigurie" mes fshatrave shqiptare në Luginën e Preshevës dhe Kosovës. Pjesët më të rrezikuara do të jenë: Zona kufitare mes Gjilanit dhe Bujanocit, në fakt brezi territorial mes fshatrave Stubllinë dhe Hodanoc (strategjikisht zonë shumë e rëndësishme për lidhjen e vendbanimeve serbe në lindje të Kosovës me Serbinë); Berivojca (fshat i përzier etnikisht afër Dardanës - ku dominimi etnik serb u mundëson serbëve që ta rrethojnë qytetin e dominuar nga shqiptarët - Dardanën dhe fshatrat Ruboc, Busovatë, Makresh i Poshtëm dhe Kllobokar; Zajçeci (me marrjen e këtij fshati në pjesën veriore të komunës së Dardanës do të vendosej një lidhje territoriale mes Serbisë dhe fshatit të banuar me serbë që quhet Gragjenik). Këtë më së miri e dëshmon fakti që në Luginën e Preshevës në afërsi të Bujanocit, në fund të këtij viti do të përfundojë ndërti-

dhe veçanërisht komuna e Gjilanit dhe e Dardanës do të kenë sfida të mëdha. Këtë e vërteton edhe vetë Qeveria e Serbisë, nënkryetari i së cilës, Miroslav Labus për gazetën "Politika" të datës 6 nëntor 2004 ka thënë: "Në kuadër të Kosovës dhe Metohisë do të duhej të formohej dy entitete. Entitetin serb do ta përbënin këto zona: Kosova Veriore (komuna e Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe veriut të Mitrovicës së Kosovës) dhe Anamorava e Kosovës (komuna e Kamenicës së Kosovës, Novobërda, Graçanica dhe pjesë të Gjilanit dhe Lipjanit)." Miroslav Labus nga përditimi konsiderohet si i moderuar dhe demokrat. Në situatën ku IPVQ-të dhe UNMIK-u po tregohen shumë të padenjë për të mbrojtur interesat e qytetarëve të Kosovës,

është detyrë e gjithsecilit qytetar të angazhohet dhe të aktivizohet për pengimin e proceseve politike që rrezikojnë ardhmërinë e vendit tonë. Një nga këto procese është edhe procesi i decentralizimit. Andaj, nëse Ju dhe ne sot nuk organizohemi në mbrojtje të së ardhmes tonë brendapërbrenda Kosovës, shumë shpejt Cernica dhe pjesë të tjera të vendit tonë do të ndodhen nën kontrollin e plotë të strukturave politike dhe të armatosura të shtetit të Serbisë, duke e bërë kështu ndarjen e Kosovës realitet. Prandaj, të qëndruarit duarkryq është legalizim i fillimit të këtij procesi, kurorëzimi i të cilit do të ishte copëtimi i vendit. Mos lejoni një gjë të tillë! Të gjithë kundër ndarjes së Kosovës. Secili për sovranitetin! Ruajtjen e tërësisë territoriale të vendit!




Tabela: Shënime statistikore të numrit të banorëve

Vendi	familje		banorë	
	Shqiptare	Serbe	Shqiptarë	Serbë
Cernica	352	114	2685	600
Parteshi	0	276	0	1434
Budriga e Poshtme	0	224	0	1250
Gjithsej:	352	614	2685	3284
<b>Përqindja:</b>			<b>44.98%</b>	<b>55.02%</b>

Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

**VETËVENDOSJE!**

**KOPJIMI LEJOHET. TË LUTEM KOPJOJE!**

Kroi i Bardhë, nr. 76  
Lagja Dardania  
Prishtinë, Kosovë

038 541411  
vetevendosje@hotmail.com  
vetevendosje@yahoo.com  
vetevendosje@gmail.com  
www.vetevendosje.org